



PRANUAR ME:
ACCEPTED ON: 31-05-2022
PRIMLJENO:
Nr.No.Br. 01/850



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E MALISHEVËS

ZYRA E KRYETARIT- NJËSIA PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN

Procesverbala nga takimi i Kryetarit z. Ekrem Kastrati, që mbajti diskutimin e parë publik me kryetarët e fshatrave të Komunës së Malishevës

Malishevë, 7 prill



Kryetari i Komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, sot ka mbajtur diskutimin e parë publik dhe tejet konstruktiv me kryetarët e fshatrave të Komunës së Malishevës.

Në këtë diskutim publik, ku i pranishëm ishte nënkryetari, Vesel Krasniqi, kryesuesi i Kuvendit, Argjend Thaçi, gjithë drejtorët e Komunës së Malishevës, dhe përfaqësuesit e kompanive publike, Hidroregjioni dhe Ekoregjioni, është diskutuar lidhur me çështjen e furnizimit me ujë të pijes, mirëmbajtjen e mjedisit dhe projektet komunale që janë në realizim dhe të planifikuara për vitin 2022, për secilin fshat.

Fillimisht, kryetari Kastrati, gjithë kryetarëve të fshatrave ju uroj mirëseardhje në takimin e parë me karakter pune, për të vazhduar më pas me diskutimin e pikave të rendit të ditës. Lidhur me pikën e parë, kryetari Kastrati tha se, të gjithë e dimë se situata e furnizimit me ujë të pijes në Komunën e Malishevës, nuk është e mirë, dhe si rrjedhojë e kësaj ne kemi ndërmarrë disa hapa, duke zhvilluar takime me institucionet qendrore, por edhe me drejtuesit e Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “Gjakova”, me të cilët kam diskutuar lidhur me mundësinë e realizimit të projektit për të kyçur komunën tonë në sistemin e Radoniqit.

Si rezultat i gjithë këtij angazhimi tonë, ditë më parë Këshilli Ndërmnistror për Ujëra, ka marrë vendim që të formohen grupet punuese për gjetjen e zgjidhjeve për furnizim me ujë nëpër komuna, ku Komuna e Malishevës është përzgjedhur si ndër të parat që kanë nevojë imediate për t’i ofruar zgjidhje, theksoi kryetari Kastrati.

Gjithashtu, kryetari Kastrati tha se, ne si Komunë kemi vazhduar edhe bashkëpunimin me kompaninë që operon tek ne, Hidroregjionin Jugor, me të cilën kemi rënë dakord që sa më parë të nënshkruajnë një Memorandum Mirëkuptimi, që i hap rrugë inicimit të disa projekteve konkrete, në funksion të shfrytëzimit maksimal të burimeve ekzistuese të ujit, si dhe mundësisë së rritjes së kapaciteteve në mënyrë që të bëjmë zgjidhje për të gjitha fshatrat e komunës sonë.

Ndërsa, lidhur me pikën e dytë, që ka të bëjë me mirëmbajtjen e mjedisit, kryetari Kastrati para kryetarëve të fshatrave tha se, kjo është një çështje që na sfidon dhe na bashkon të gjithëve, pa dallim.



“Muajin Prill e kemi shpallur muaj të pastrimit të ambientit, dhe në funksion të kësaj më datë 5 Prill kemi marrë një aksion të madh të pastrimit, ku i janë përgjigjur të gjitha institucionet lokale dhe qytetarë të shumtë. Në bazë të planit, Prilli Muaj i Pastrimit të Ambientit, drejtorja përkatëse në bashkëpunim me kompaninë Hidroregjioni, ditëve në vijim do të vazhdojnë me aktivitete tjera, ku përmes këtij aksioni të pastrimit, do të vazhdojmë edhe me eliminimin e pikave inerte nëpër fshatrat e Komunës së Malishevës”, theksoi kryetari Kastrati.

Ndërsa, lidhur me pikën e tretë të diskutimit, realizimi i projekteve nëpër fshatra, është zhvilluar një diskutim i mirëfilltë, ku kryetarët e fshatrave kanë ngritur çështje dhe kanë adresuar pyetje lidhur me projekte të ndryshme nëpër fshatrat që përfaqësojnë, ku për të gjitha këto, përgjigje kanë marrë nga kryetari Kastrati, nga drejtorët që ishin të pranishëm, dhe nga përfaqësuesit e kompanive publike.

Në këtë takim, ka folur edhe nënkryetari Vesel Krasniqi, ku mes tjerash ai ka diskutuar, lidhur me vendim e kryetarit Kastrati për formimin e një Task Force Komunale, e cila ka për qëllim menaxhimin e situatës emergjente, lidhur me kujdesin për një mjedis sa më të pastër, konkretisht për menaxhimin e mbeturinave inerte dhe mbeturinave tjera në territorin e komunës së Malishevës, por edhe me pikën e mësipërme të cilën e diskutuam, pra; gjendjen e furnizimit me ujë të pijes.

Në këtë takim veç këtyre 3 pikave bazë, është diskutuar edhe për çështje tjera me rëndësi, për subvencionet në bujqësi, parandalimin e përhapjes së etheve hemorragjike, infrastrukturës shkollore, etj.

Kryetari Kastrati i falënderoj drejtuesit e fshatrave për pjesëmarrjen në takim dhe për debatin konstruktiv që i shërben një qeverisje sa më të mirë e gjithëpërfshirëse, dhe i siguroj që secila kërkesë e tyre që është shtruar në këtë takim, do të trajtohet në kohë nga drejtoritë tona përkatëse.

Në fund, kryetari Kastrati, tha se këto diskutime publike do ti mbajmë prapë, ashtu siç janë të parapara edhe me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale.



Ahmet Rrahmanaj- kryetar i fshatit Bubël- Kërkoi një bashkëpunim me ekzekutivin, përmbushje të planit dhe realizim të projekteve si dhe më urgjente sipas tij ishte trajtimi me qenë endacak, largimi i deponive të mbeturinave inert dhe dhënia në shfrytëzim e pronës publike , duke i respektuar aktet normative dhe ato ligjore në fuqi.

Afrim Mazreku- Kryetar i fshatit Gurishtë- Kërkesat e tij ishin: Të sigurohet transporti i nxënësve me disa lehtësira nga fshatrat deri në SHML-të, furnizimi me ujë të pjshëm, marrja e masave për luftimin e etheve hemorragjike të rriqrave, ndërrimi i rrjetit elektrik si dhe ndriçimi në fshat, mirëmbajtja e mjedisit, dhe rregullimi i kolektorit për ujërat e zeza.

Bajram Paçarizi- Kryetar i fshatit Lumishtë- Rregullimi i disa lagjeve me kanalizim, largimi i mbeturinave dhe të sanksionohen hedhësit e paligjshëm në hapësirat publike, rrjeti i enregjisë, të rriten subvencionet për serra dhe shtalla më shumë se me nga 1 ari hapësira , që të kemi zhvillim të qendrueshëm.

Mufail Helshani- Kryetar i fshatit Ngucat- Edhe kërkesat e tij ishin që ujësjellësi në fshat të kyqen në kompaninë e hidroregjionit - njësia lokale në Malishevë, dhe dis akërkesa identike si të parafolësve më lartë.

Demir Bajraj- Kryetar i fshatit Panorc- Të rirregullohet ujëmbledhësi i fshatit, të investohet në disa lagje infrastruktura rrugore, dhe të ketë mbikqyrje të zbatimit të projekteve brenda afatit kohor.

Negjmedin Shurdhaj- Nënkyetar i fshatit Banjë- Kërkesat ishin, Furnizimi me ujë të pijshëm në pikat e larta të fshatit, Banja të ketë një dalje të veçantë për ujë të pijes për banorët, të investohet në disa lagje me shtylla elektrike të betonit , pasi kanë mbetur pa u mbaruar, rregullimi i shtratit të lumit Mirusha në fshat, si dhe vendosja e ndriçimit.

Mursel Zogaj- kryetar i fshatit Lladroc-Rregullimi i trotuarit, të krijohet mundësia e një ujëmbledhësi pasi fsahti dhe relivi gjeografik e mundëson një gjë të tillë- për Digë, dhe infrastruktura rrugore të plotësohet në disa lagje.

Zymer Zogaj- Nënkyetar i fshatit Bellanicë- Çështja me ujë të pijes të rregullohet , trajtim i qenëve endacak, çështja e mbeturinave.

Hajrush Kavaj - Kryetar i fshatit Temeqinë- Aneksi i shkollës të bëhet, ndriçimi, kanalizimi dhe uji i pijes.

Ilir Gajraku- kryetar i fshatit Gajrak- Të ndërtohet bazeni i ujit në fshatin si pika më e lartë, , trotuari dhe vendosja e disa shenjave të trafikut në rrugë.

Edhe pjesa dërmuese e kryetarëve të fshatrave që morën pjesë në takim, kërkesat i kishin të njëjta me të parafolësve, kërkesa që ishin jo të parealizueshme pasi në pjesën më të madhe të

fsahtrave dhe lagjeve janë të kryera infrastruktura rrugore, kanalizimi, trotuarët, uji i pijes, ,
bartja e mbeturinave.

Për të gjitha këto kërkesa, pos përfaqësuesve të ekzekutivit, iu përgjigjen kërkesave të kryetarëve
të fshatrave edhe drejtori i Kompanisë Hidroregionit Njësia në Malishevë, Njazi Bytyçi, si dhe i
Ekoregjionit, njësia në Malishevë, Sejdi Paçarizi.

Procesverbalit i bashkangjitet edhe lista me nënshkrimet e kryetarëve të fsahtrave pjesëmarrës
në takim.

Malishevë, 20. 04.2022

NKP- Procesmbajtësi

Izet Shala



Komuna e Malishevës

Zyra e Kryetarit të Komunës

Lista e nënshkrimeve të pjesëmarrësve në Diskutimin Publik të Kryetarit të Komunës, z.Ekrem
Kastrati me kryetar të fshatrave dhe qytetarë, i mbajtur më 07.04.2022, në ora 11:00.

Numri rendor	Emri dhe mbiemri	Fshati- vendbanimi	Numri i telefonit	Nënshkrimi
1.	GËZIM KRASNIQI	PAGARUSHË	044-803-166	<i>Gëzim</i>
2.	AFRIM MAZDEKU	GURIQ	049-607-600	<i>Alfred</i>
3.	Musael Logaj	Jakovc	044758291	<i>Musael</i>
4.	Recep Hoxhi	Coroduka	045-985-179	<i>Recep</i>
5.	Berim Morina	Astrozup	049733887	<i>Berim</i>
6.	Luani Bytyqi	SHKOZË	049148365	<i>Luani</i>
7.	Arben Sopaj	Jancit	049213740	<i>Arben</i>
8.	Exmer Logaj	Bellonicë	041389985	<i>Exmer</i>
9.	Malig Serzollit	Bellanicë	044-186770	<i>Malig</i>
10.	HASAN VRENEZI	MARALI	044289-232	<i>Hasan</i>
11.	Enkel Borila	Beleshi	044-274570	<i>Enkel</i>
12.	Arben Zogaj	Fshati i Ri	049-416-881	<i>Arben</i>
13.	Demir Bajra	Panor	049-204-115	<i>Demir</i>
14.	BEJIM RAMA	SENIK	044289351	<i>Bej</i>
15.	Luizim Morzeku	Malishevë	049104480	<i>Luizim</i>

16.	Salih Elshani	OSBE -72	049 950 278	Shkëmbi
17.	NEHAT KAS KICU	DREKOC	044-229 540	Shkëmbi
18.	Ilir Gajioke	Gajioke	044 628 691	Banë
19.	SEJDI PASARIZI	EKOREGJION	045 133 071	Shkëmbi
20.	Njazi Bytyci	HIDROREGIONI	044/391-926	Shkëmbi
21.	HASANI MORINA	GULLBOC	049/126/284	Hllorimç
22.	AHMET ERHMANAJ	BUBEC	048/214/285	Shkëmbi
23.	Harhi Kastani	Turjakë	049/244-563	Shkëmbi
24.	Mefur Helldon	Kpucat	044 177 730	Mblat
25.	Nexhmedin Shurdhij	Bonje	044/289/390	Nshurdhij
26.	Hajrudin Kavaja	Temegjin	049 655 272	Shkëmbi
27.	Bayram Bytyci	Llaziç	044 362 366	Shkëmbi
28.	Devit Marina	Lubizhdë	044 204 810	Shkëmbi
29.	Bayram Bytyci	Lubizhdë	045-355-392	Shkëmbi
30.	Ismet Kryeziu	MLegon	044 419 024	Shkëmbi
31.	Miftar Javori	Llaziç	049/586-578	Shkëmbi
32.	FEMI KRIEZIU	BUBAVEC	044-312-680	Shkëmbi
33.	Arnti-Bytyci	Bubrec	044-689-469	Shkëmbi
34.				
35.				
36.				
37.				
38.				